



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 62

Prishtinë, më 20.4.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Salih Salihu, Adem Salihaj, Time Kadrijaj, Haxhi Shala, Sergjan Popoviq, Shaip Muja.

Munguan : Emilija Rexhepi, Murat Hoxha.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 5.4.2017;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Komplekseve Memoriale për vitin 2016 ;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja, **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen, sipas rendit të përcaktuar të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës, për këtë mbledhje, u miratua pa ndonjë shtesë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 5.4.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 5.4.2017, u miratua pa vërejtje.

1.Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Komplekseve Memoriale për vitin 2016

Kryetarja, Duda Balje, falënderoi për pjesëmarrje të mysafirëve nga agjencia dhe ftoi drejtorin **Idriz Blakaj** të marr fjalën. Ai falënderoi komisionin dhe raportoi në pika të shkurta, duke potencuar se kjo agjenci ngadalë por me sukses po rimëkëmbet. Deri tani janë zgjedhur problemet teknike, kurse problemet tjera profesionale fatkeqësisht mbeten mjaft mbrapa për tu zgjidhur siç është shtimi i stafit të domosdoshëm, jo nga 12 punëtor në 52 sa duhen, por së paku edhe për 5 punëtor nevojiten urgjentisht, gjithashtu diskutoi për projektet aktuale që janë duke u realizuar në agjenci ato që janë më të rëndësishme. **Adem Salihaj** falënderoj për raportimin drejtorin dhe u fokusua në problemet reale dhe jetike të agjencisë e jo të zgjerohet kjo agjenci në realizimin e disa projekteve të cilat jo që injorojnë historinë tonë por ato duhet të janë graduale, si p.sh. projekti i shtatores së Hasan Prishtinës në Vushtri nuk mund të zë vend para atyre që janë më të rëndësishme pas vitit 1999. Sa i përket vështirësive profesionale që janë të lidhura me financa, sugjeroi që kjo agjenci të hartoi jo vetëm listën e kërkesave por ti arsyetoi shumë më fuqimisht ato, në mënyrë që të gjejnë zgjidhje në segmentet qeveritare fillimisht, pastaj edhe në kuvend dhe ky angazhim të jetë i vazhdueshëm e jo të ceken vetëm me një raport vjetor, gjithashtu ai vërejti se me raport disa gjëra përsëriten dhe sugjeroi që kjo agjenci mos ti hyn projekteve për të cilat nuk ka mbulesë financiare ngase ato mandej mbeten në gjysmë. **Time Kadrijaj** falënderoi zyrtarët e kësaj agjencie siç tha ajo për një punë madhore dhe të rëndësishme për Kosovën, kurse për raportin e drejtorit falënderoi duke pyet rreth masakrës më të madhe të Mejes a ka ndonjë angazhim konkret kjo agjenci. **Haxhi Shala** gjithashtu konsideroi punën e kësaj agjencie madhore dhe të rëndësishme duke sugjeruar që ndoshta do të shkonin punët më rregull nëse do të angazhohej një kompani që mbikëqyr punimet nëpër komplekse të ndryshme që synohen të ndërtohen, pyetje konkrete bëri a ka ndonjë risi rreth një shtatore në Prishtinë të Adem Jasharit dhe për Kleqkë. **Shaip Muja** ishte i mendimit se sot komisioni edhe poçes miraton këtë raport vjetor, bashkëpunimi duhet të jetë i vazhdueshëm dhe funksional i agjencisë me komisionin sidomos për shtimin e kuadrove të domosdoshëm, ngase kjo agjenci vazhdimisht koordinohet me komuna por nga ato nuk ka bashkëpunim të duhur, kërkesa për 52 punëtor asnjëherë nuk realizohet nëse nuk hyn kjo në hierarki me 37 komuna dmth duhet mu ulë dhe konkretisht të realizohen kërkesat e agjencisë. **Kryetarja Duda Balje** pyetje konkrete kishte sa punëtorë urgjentisht i nevojitet agjencisë. **Idriz Blakaj** filloi me përgjigje të pyetjes së fundit dhe tha se 5 punëtorë janë mëse të nevojshëm në agjenci për

të cilat edhe në ministrinë e financave kanë kërkuar dhe kanë marr përgjigje pozitive, por ende nuk ka realizim konkret, ndërsa rreth konstatimit të Adem Salihajt se gjërat po përsëriten tha se ai nuk është fajtor ngase edhe ai nuk kupton p.sh. pse vonohet përcjellja e projekteve nga MMPH në agjenci dhe disa gjëra tjera me rëndësi. Për pyetjen e znj. Kadrijaj për Meje tha se tenderi është shpallur dhe procedimi vazhdon, dhe sqaroi edhe për disa projekte tjera siç është ajo e Adem Jasharit në kryeqytet (pyetja nga **Haxhi Shala**), për të cilin konstatoi se është obligim i institucioneve qendrore të iniciojnë e jo komunale, kurse agjencia vetëm i zbaton ato iniciativa nëse ka.

Kryetarja ftoi komisionin për miratimin e raportit, dhe nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Miratohet raporti vjetor i agjencisë së komplekseve memoriale për vitin 2016 për të cilin rekomandohet mbledhja plenare gjithashtu të miratoi atë.

4.Të ndryshme

Në pikën të ndryshme **Time Kadrijaj** sugjeroi stafin të kontaktoi stafin e komisionit për integritet evropiane për një vizitë të mundshme të këtij komisioni në Budapest, kurse **Shaip Muja** në cilësinë e kryesuesit dhe Grupi Punues për projektligjin për kompleksin Adem Jashari, pas takimit të mbajtur me zyrtarët e agjencisë pas mbledhjes, vendosi që ky projektligj të renditet për mbledhjen e radhës së komisionit për leximin e dytë. **Kryetarja** caktoi mbledhjen për ditën e mërkure me pikat : Raportimi nga ARRU, projektligji për Adem Jasharin dhe zhurmën si dhe çështjet tjera të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje